



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË _____.202_

PËR

**MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE QË
KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin sociale”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 814 datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, VKM nr. 301 datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qera që blihen në treg të lirë dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 852, datë 26.12.2024 Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit për përfitimin nga programet e strehimit social, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të gjykojë konform akteve ligjore dhe,

TË VENDOSË

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e familjeve që kërkojnë të përfitojnë nga programet e strehimit social sipas tabelës së mëposhtme:

	KRITERET	SHKALLA E VLERËSIMIT
1	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpinë me një numër të madh pjesëtarësh të familjes me një sipërfaqe të banuar nën normat e strehimit.	0/20
2	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpi me një numër të madh pjesëtarësh të familjes ku banesa ka kushte jo të mira sanitare ose rrezikon shembjen	0/5
3	Familjet që u janë dëmtuar banesa nga tërmeti i rënë me datë 21.09.2019 dhe 26.11.2019, të cilat nuk janë përfshirë në zonat e shpallura për zhvillim	0/5
4	Familjet me nevoja të veçanta në një nga kategoritë e mëposhtme :	0/20
	a. Personat të moshuar në moshe pensioni dhe që nuk mund të përzgjidhen për të përfituar strehim nga institucionet sociale të kujdesit publik.	0/5
	b. Individët me aftësi të kufizuara, që kanë statusin e personit të verbër dhe që i përket grupit të parë, invalidët si për shembull paraplegjikët, invalidët e punës ose të luftës së dytë botërore.	0/10
	c. Individët me statusin e jetimit, nga momenti që ata braktisin jetimoren ose qendrat e përkujdesjes deri në moshën 30 vjeçare	0/5
5	Familjet në vështirësi ekonomike në një nga kategoritë e mëposhtme:	0/10
	a. Familjet me një prind të vetëm me fëmijën në ngarkim ku kryefamiljare është i/e ve ose i/e divorcuar ose familje me më shumë se 4 fëmijë	0/3
	b. Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0/2
	c. Viktimat e dhunës në familje, me urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata	0/3
	d. Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	0/2
6	Familjet e përshtatshme për ndihmë për strehim në një prej kategorive të mëposhtme:	0/10
	a. Familjet e reja, të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	0/3
	b. Familjet e emigrantit i rikthyer, punëtor emigrant dhe azilkërkuesit; refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese në kuptim të legjislacionit përkatës	0/2
	c. Familje të komunitetit rom dhe egjiptian ose Familje që përfitojnë nga ligji nr.82/2012 "për miratimin e aktit Normativ nr.3 datë 01.08.2012 "Për lirimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarë të pastrehë banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar."	0/5

7	Kategoritë e të ardhurave	0/30
	a.Kufiri maksimal i të ardhurave deri 75% e të ardhurave mesatare kombëtare	
	Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (65,896-72,346) Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (83,501– 94,094) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (99,501– 110,618) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (111,001–111,776) Lekë	0/5
	b.(niveli mesatar i të ardhurave)	
	Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (58,593 –65,895) Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (78,501–83,500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (96,501–99,500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (110,801–111,000) Lekë	0/10
	c.(niveli minimal i të ardhurave)	
	Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (55,835 – 58,592) Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (72,346 – 78.500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (94,094 – 96.500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestare dhe më të ardhura mujore nga (110,618 –110,800) Lekë	0/15

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör
Alneida Rroshi

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL**

Drejtör
Diola Xhango

KRYETAR
Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

RELACION

PËR
MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR FAMILJET QË KËRKOJNË
TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin sociale”, i ndryshuar me nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin sociale”, VKM nr.814 datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, VKM nr.301 datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qera që blihen në treg të lirë dhe banesat me kosto të ulët”, VKM Nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti” VKM Nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 852, datë 26.12.2024 “Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit për përfitimin nga programet e strehimit social, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Të nderuar këshilltarë,

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin sociale”, i ndryshuar me nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin sociale”, parashikon se përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi në të cilën vërtetohen një sërë kriteresh si:

- a)Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
- i) nuk disponojnë banesë në pronësi;
 - ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje
 - iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;
 - iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.
- b)Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:
- i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;

- ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
- iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
- iv) familje të reja.
- v) të rinjë në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç
- c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:
 - i) personat me aftësi të kufizuara, sipas pikës 28 të nenit 2 të këtij ligji
 - ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;
 - iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve;
 - iv) emigranti i rikthyer, punëtor emigrant dhe azilkërkuesit; refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese në kuptim të legjislacionit përkatës;
 - v) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);
 - vii) punonjësit e repartit RENE A;
 - viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
 - xi) viktimat e dhunës në familje me urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata
 - xii) anëtarët e komunitetit rom;
 - xiii) anëtarë të komunitetit egjiptian;
 - xiv) të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;
 - xv) vajzat nëna;
 - xvi) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.
- ç) Gjendja ekonomike, në bazë të së cilës përcaktohen familjet sipas grupeve të të ardhurave.

Sistemi i pikëzimit miratohet me vendim të Këshillit të Njësisë së Qeverisjes Vendore për çdo program që zbatohet në një Njësi të Qeverisjes Vendore dhe bazohet në kriteret e përcaktuara më sipër.

Bazuar në Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin sociale”, i ndryshuar me nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin sociale”, Bashkisë Durrës duke qenë se ka filluar procedura e aplikimit për programet e strehimit social është e domosdoshme miratimi i sistemit të pikëzimit për familjet që do të aplikojnë në këto program strehimi.

Gjithashtu përsa i përket nivelit të të ardhurave janë marrë në konsideratë të dhënat e dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Strehimit me shkresën nr.12836/2 prot datë 13.11.2024 protokolluar me tonën me nr. 13394 prot datë 15.11.2024 “Mbi kërkesën për informacion” për nivelin e konsumit të detajuar sipas madhësisë së për çdo qark sipas INSTAT-in .

Sic ju sqaruam më sipër hapi i parë i kësaj procedure është miratimi i sistemit të pikëzimit dhe më tej vijohet procedura e aplikimeve për apartamentet respektive deri në përfundim të procesit që përkon me lidhjen e kontratës.

KRITERET		SHKALLA E VLERËSIMIT
1	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpinë me një numër të madh pjesëtarësh të familjes me një sipërfaqe të banuar nën normat e strehimit.	0/20
2	Jetoni në shtëpi private me qira ose ndani shtëpi me një numër të madh pjesëtarësh të familjes ku banesa ka kushte jo të mira sanitare ose rrezikon shembjen	0/5
3	Familjet që u janë dëmtuar banesa nga tërmeti i rënë me datë 21.09.2019 dhe 26.11.2019, të cilat nuk janë përfshirë në zonat e shpallura për zhvillim	0/5
4	Familjet me nevoja të veçanta në një nga kategoritë e mëposhtme :	0/20
	a. Personat të moshuar në moshe pensioni dhe që nuk mund të përzgjidhen për të përfituar strehim nga institucionet sociale të kujdesit publik.	0/5
	b. Individët me aftësi të kufizuara, që kanë statusin e personit të verbër dhe që i përkasin grupit të parë, invalidët si për shembull paraplegjikët, invalidët e punës ose të luftës së dytë botërore.	0/10
	c. Individët me statusin e jetimit, nga momenti që ata braktisin jetimoren ose qendrat e përkujdesjes deri në moshën 30 vjeçare	0/5
5	Familjet në vështirësi ekonomike në një nga kategoritë e mëposhtme:	0/10
	a. Familjet me një prind të vetëm me fëmijën në ngarkim ku kryefamiljare është i/e ve ose i/e divorcuar ose familje me më shumë së 4 fëmijë	0/3
	b. Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0/2
	c. Viktimat e dhunës në familje, me urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata	0/3
	d. Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	0/2
6	Familjet e përshtatshme për ndihmë për strehim në një prej kategorive të mëposhtme:	0/10
	a. Familjet e reja, të rinjqë në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	0/3
	b. Familjet e emigranti i rikthyer, punëtor emigrant dhe azilkërkuesit; refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese në kuptim të legjislacionit përkatës	0/2
	c. Familje të komunitetit rom dhe egjiptian ose Familje që përfitojnë nga ligji nr.82/2012 "për miratimin e aktit Normativ nr.3 datë 01.08.2012 "Për lirimimin e banesave të pronarëve të ligjshëm nga qytetarë të pastrehë banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar."	0/5
7	Kategoritë e të ardhurave	0/30
	a. Kufiri maksimal i të ardhurave deri 75% e të ardhurave mesatare kombëtare	
	Ap (1+1) për familjet me 2 pjesarë dhe me të ardhura mujore nga (65,896-72,346) Lekë. Ap (1+1) për familjet me 3 pjesarë dhe me të ardhura mujore nga (83,501- 94,094) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjesarë dhe me të ardhura mujore nga (99,501- 110,618) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjesarë dhe me të ardhura mujore nga (111,001-111,776) Lekë	0/5

b.(niveli mesatar i të ardhurave) Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (58,593 –65,895) Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (78,501–83,500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (96,501–99,500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (110,801–111,000) Lekë	0/10
c.(niveli minimal i të ardhurave) Ap (1+1) për familjet me 2 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (55,835 – 58,592) Lekë Ap (1+1) për familjet me 3 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (72,346 – 78.500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 4 pjestarë dhe me të ardhura mujore nga (94,094 – 96.500) Lekë Ap (2+1) për familjet me 5 pjestare dhe më të ardhura mujore nga (110,618 –110,800) Lekë	0/15

Shënim :

1. Për familjet që klasifikohen me pike të barabarta do të kenë prioritet familjet me numër më të madh pjestarësh.
2. Familjet me tre pjestare që përfitojnë sipërfaqe banimi shtesë sipas VKM-së Nr 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet socialite strehimit” do të trajtohen me Ap 2+1 pasi të jenë trajtuar me pare familjet me katër dhe pesë pjesëtare.

PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE SOCIALE

SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

DREJTORI

DIOLA XHANÇO